

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Hagës e lidh drejtpërdrejt Hashim Thaçin me arrestimin dhe vrasjen e Behajdin Allaqit
ADRESA	https://albeu.com/kosove/gjykata-e-hages-e-lidh-drejtperdrejt-hashim-thacin-me-arrestimi n-dhe-vrasjen-e-behajdin-allaqit/1014236/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:08:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:08:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	45df8fe063d87acc852d20abc277714f5307faf7598f6ecbe81bd06838038092
TEKSTI	29459abd285d42f1e2371060f9aa52c6232c5d2fb4672480550c269766be626c
PAMJA	f906248f76043ffca679d0d2bd2305e8b9c99e0153cb83db99a2efae90b44e2b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8f41b82621c95feeb6464dfaa088fcb4ba88c5e464addf426977a7b66efe3db1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8f41b82621c95feeb6464dfaa088fcb4ba88c5e464addf426977a7b66efe3db1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjykata e Hagës e lidh drejtpërdrejt Hashim Thaçin me arrestimin dhe vrasjen e Behajdin Allaqit



Pas më shumë se 28 vjetësh pa një përgjigje përfundimtare, rasti i zhdukjes dhe vrasjes së veprimtarit Behajdin Allaqi mori një konstatim gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Gjatë shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses deklaroi se Thaçi kishte marrë pjesë personalisht në krimet e kryera ndaj Allaqit.

Në përmbledhjen e aktgjykimit thuhet se Hashim Thaçi ishte i përfshirë drejtpërdrejt në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e Behajdin Allaqit. Në të njëjtin dokument përmendet edhe pjesëmarrja e tij në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve.

Ky vlerësim i Gjykatës lidhet me përgjegjësinë individuale të Thaçit në rastin Allaqi dhe nuk paraqet vetëm një përgjegjësi të përgjithshme për veprimet e personave të tjerë.

Vendimi, i shpallur më 16 shtator 2026, është i shkallës së parë dhe mund të kundërshtohet nga mbrojtja përmes apelit. Thaçi është dënuar me 25 vjet burgim, ndërsa aktgjykimi nuk konsiderohet ende i formës së prerë.

Behajdin Allaqi lindi më 7 prill 1963 në Prizren. Ai ishte veprimtar politik, intelektual dhe pjesëtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, ndërsa angazhimin në organizimet politike shqiptare e kishte nisur që në vitet '80.

Gjatë vitit 1981, Allaqi mori pjesë në demonstrata, ndërsa më pas vazhdoi veprimtarinë ilegale për avancimin e statusit politik të Kosovës. Në vitet '90 ai ishte aktiv në strukturat e lëvizjes kombëtare dhe më vonë iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Allaqi u zhduk më 11 qershor 1998. Trupi i tij nuk është gjetur dhe, deri në aktgjykimin e së mërkurës,

të fundit /



Gjykata e Hagës e lidh drejtpërdrejt Hashim Thaçin me arrestimin...



Abdixhiku: Vendimi i Hagës nuk e ndryshon të vërtetën historike t...



Chelsea mbetet jashtë garës për "Messin e ri" të Manchester Unitedit



Ali Ahmeti: Vendimi ndaj ish-drejtuësve të UÇK-së është i...



Bajram Begaj pas vendimit të Hagës: UÇK-në nuk mund ta...



Veteranët e UÇK-së kundërshtojnë aktgjykimin ndaj Thaç...



Familjarët e Thaçit dhe Veselit largohen pa deklarata pas vendim...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Institucionet vendore nuk kishin anene një shpjegim përundimtar për rastin e tij.

Gjatë gjithë kësaj kohe, familjarët, bashkëveprimtarët dhe figura publike kërkuar zbardhjen e rrethanave që lidhen me arrestimin, zhdukjen dhe vrasjen e tij.

Sipas përmbledhjes së aktgjykimit, Thaçi kishte qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe drejtues i Drejtorisë Politike të UÇK-së. Në këtë cilësi, sipas Gjykatës, ai kishte pasur rol kyç në hartimin dhe zbatimin e një qëllimi të përbashkët.

Ky qëllim përfshinte identifikimin e personave që perceptoheshin si kundërshtarë të UÇK-së, arrestimin dhe ndalimin e tyre, si dhe krijimin dhe funksionimin e objekteve të ndalimit.

Gjykata përfshiu në këtë kuadër edhe keqtrajtimin dhe, në raste të caktuara, vrasjen e të ndaluarve, si dhe përdorimin e deklaratave e komunikatave publike kundër personave të cilësuar si "bashkëpunëtorë" ose kundërshtarë.

Trupi Gjykses arriti në përfundimin se Thaçi kishte kontribuar në këtë qëllim të përbashkët dhe se kishte marrë pjesë vetë në disa prej krimeve. Në mesin e rasteve të përmendura ishte edhe ai i Behajdin Allaqit.

Për rastin Allaqi, Gjykata renditi katër etapa të pjesëmarrjes së Thaçit: arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme.

Edhe Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u shpallën përgjegjës nga Trupi Gjykses për kontributin e tyre në qëllimin e përbashkët kriminal ndaj personave të perceptuar si kundërshtarë të UÇK-së.

Megjithatë, përmbledhja publike e aktgjykimit nuk thotë se Veseli, Selimi dhe Krasniqi morën pjesë personalisht në arrestimin apo vrasjen e Behajdin Allaqit.

Për rrjedhojë, aktgjykimi nuk duhet interpretuar si konstatim se të katër të akuzuarit u identifikuan si ekzekutorë ose bashkautorë të drejtpërdrejtë të vrasjes. Në rastin Allaqi, konstatimi individual i bërë publik lidhet shprehimisht me Hashim Thaçin.

Emri i Behajdin Allaqit ishte përmendur ndër vite në deklarata publike, dëshmi dhe përplasje politike. Në të kaluarën ishin ngritur edhe pretendime për marrëdhënie të tensionuara mes tij dhe disa prej drejtuesve politikë të atëhershëm të UÇK-së.

Megjithatë, këto pretendime nuk kishin përbërë një vendim gjyqësor dhe çështja kishte mbetur e pazbardhur.

Aktgjykimi i 16 shtatorit 2026 shënon herën e parë kur një trup gjykses ka konstatuar përgjegjësi individuale të Thaçit për arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqit.

Përmbledhja e vendimit është raportuar edhe nga The Guardian, ndërsa është publikuar edhe raportimi i drejtpërdrejtë nga seanca. Dokumenti i plotë i aktgjykimit dhe transkripti zyrtar pritet të bëhen publike në bazën e dokumenteve të Dhomave të Specializuara.

Shtuar më 16.09.2026 13:08

Tags: Behajdin Allaqi , Gjykata e lidh Thaçin , Hashim Thaçi , me vrasjen e Behajdin Allaqit , tronditi Kosovën



Avokati i Thaçit paralajmëron apelin: Ditë e zezë për drejtësinë...



Abdixhiku: Vendimi i Hagës nuk e ndryshon të vërtetën historike të luftës në...



Ali Ahmeti: Vendimi ndaj ish-drejtesve të UÇK-së është i padrejtë, beteja...



Bajram Begaj pas vendimit të Hagës: UÇK-në nuk mund ta njollojë askush



Veteranët e UÇK-së kundërshtojnë aktgjykimin



Familjarët e Thaçit dhe Veselit larmohet na



Balla: Aktgjykimi i Hagës ndaj ish-drejtesve të UÇK-së



Për cilat akuza u dënuar ish-drejtesit e UÇK-së në

konferencës së shtypit të ndaj Thaçit, Veselit, Seli...

Veseli largohet pa deklarata pas vendimit p...

ndaj ish-argjeshëve të sht... së nuk përfaqëson...

ish-argjeshëve të sht... Hagë?



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.